KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË SHËNDETIT NGA SËMUNDJET

Shoqëria ALBSIG Sha., me seli në Tiranë me adresë Bulevardi Bajram Curri, Downtown One, Tiranë, Albania regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin për Regjistrimin si Person Juridik Nr. 30756 datë 09/01/2004, perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem Z. Muharrem BARDHOCI, dhe bien dakort si me poshte:

1. "DISPOZITA TE PERGJITHSHME"

Kushtet e pergjithshme te kontrates per sigurimin e Semundjeve dhe Aksidenteve, ketu e me poshte do te quhen **"Kushtet e Sigurimit"**; Shoqeria e Sigurimeve "ALBSIG Sh.a", ketu e me poshte do te quhet **"Siguruesi"**; Personi fizik, interesi pasuror i te cilitmbulohet nga sigurimi per Shendetin dhe Aksidentet Personale, ketu e me poshte do te quhet **"I Siguruari"**; Personi fizik apo juridik qe nenshkruan policen e sigurimit, ketu e me poshte do te quhet **"Kontraktuesi";** Kontrata per sigurimin e Shendetit dhe Aksidentet Personale e lidhur midis Siguruesit dhe te Siguruarit, ketu e meposhte do te quhet **"Polica e Sigurimit";** Perfituesi sipas dispozitave ligjore mbi trashegimine, ose personi tjeter i emeruar nga i Siguruari i cili perfiton nga polica e sigurimit, ketu e me poshte do te quhet **"Perfituesi";** Shuma e parave qe i siguruari paguan per sigurimin Brenda intervalit te kohes se rene dakort, ketu e meposhte do te quhet **"Primi i Sigurimit";** Shuma maksimale e parave te paguashme nga siguruesi ne rast demi, ketu e meposhte do te quhet **"Shuma e Sigurimit"**; Çdo anormalitet, apo situate semundje qe ndodh ne funksion te organeve te trupit te personit te siguruar, qe nuk varet nga vullneti i te siguruarit dhe shkaktohet nga ndryshime patologjike te cilat mund te diagnostikohen nga nje doctor, ketu e meposhte do te quhet **"Semundje";** Trajtimi qe duhet bere ne Spitalin Amerikan dhe per te cilin i siguruari duhet te shtrohet te pakten nje nate,ketu e meposhte do te quhet **"Shtrim Spitalor"**. Nuk do te konsiderohet i tille qendrimi i te siguruarit brenda nje institucioni spitalor per nje periudhe me te gjate se ajo e nevojshme ose nese eshte shtruar dhe nuk diagnostikohet asnje gjendje patologjike.

2. "RREZIQET E SIGURIMIT"

Sigurimi i shendetit dhe i aksidenteve personale mbulon, brenda afatit te sigurimit, shpenzimet e nevojshme te kurimit per paaftesine shendetesore ne rast te semundjes e cila shfaqet ne menyre akute ose papritur, e cila nuk ka qene e mbartur apo semundje me historik nga i siguruari dhe/ose plagosjes, qe peson i Siguruari gjate ushtrimit te veprimtarise profesionale, te treguar ne policen e sigurimit, si dhe te çdo veprimtarie tjeter qe nuk ka karakter profesional, me kusht qe rreziku i mbuluar me sigurim te mos perfshihet ne "rreziqet e perjashtuara". Sigurimi nga semundjet i garanton te Siguruarit shpenzimet e nevojshme te kurimit, deri ne shumen e percaktuar ne Kontrate. Sigurimi i shendetit nga aksidentet personale mbulon aksidentet qe peson I Siguruari per shkak te: **a)** helmimit akut nga thithja apo gelltitja e substancave; **b)** mbytjes nga trupa te huaj, ne rruget e frymemarrjes ne menyre te pa vullnetshme. **c)** ngrirjes; **d)** goditjes se diellit ose nxehtesise; **e)** demtimeve te shkaktuara nga sforcime fizike, me perjashtim te hernies dhe infarktit; **f)** asfiksise me origjine jo patologjike; **g)** aksidenteve te pesuara ne gjendje semundjeje te menjehershme ose pavetedijes; **h)** trazirave masive civile ose

akteve terroriste, me kusht qe I Siguruari te mos kete marre pjese aktivisht ne to.

3. "RREZIQE TE PERJASHTUARA"

Sigurimi i shendetit nuk mbulon aksidentet qe peson i Siguruari per shkak te situatave te meposhtme: **a)** drejtimit apo bashkedrejtimit te nje mjeti motorrik ose mjeti lundrues me motorr, si dhe qendrimit si pasagjer gjate pjesemarrjes se tyre ne gara e konkurrime sportive dhe ne provat perkatese; **b)** drejtimit te mjetit motorrik ose mjetit lundrues me motor, kur vete i Siguruari nuk eshte i pajisur me dokumentin perkates te aftesise; **c)** drejtimit te nje mjeti fluturimi me motorr ose punesimit si anetar i ekuipazhit te tij; **d)** kryerjes se detyres profesionale duke perdorur mjete fluturimi me motorr; **e)** perdorimit te aeroplaneve pa motorr, qendrimit si pasagjere ne to si dhe parashutimit; **f)** ushtrimit te boksit, atletikes se rende, futbollit,mundjes apo sporteve te ngjashme me te, alpinizmit, kercimit nga trampolina me ski ose hidroski, skive akrobatike, zhytjes me bombulat e eksplorimit; **g)** pjesemarrjes ne konkurime dhe stervitjet perkatese te futbollit, hipizmit e çiklizmit, **h)** dehjes dhe/apo perdorimit te tepruar te psikofarmaceutikeve, te perdorimit te droges ose aluçinanteve me perqindje alkoli me te larte se 0.2%0 (per mije); **i)** operacioneve luftarake, zhvillimit te kryengritjeve, permbytjeve, zhvendosjes se tokes e shperthimeve vullkanike; **j)** shperthimeve dhe radiacionit te energjise berthamore, pavaresisht nga origjina e tyre; **k)** kryerjes ose tentatives per kryerjen e nje vepre penale;**l)** virusi HIV (AIDS); **m)** lindja e femijes, aborti dhe ne pergjithesi cdo situate e lidhur me lindjen ose terapi per shtatzani; **n)** shqetesimet kongjenitale dhe gjenetike; **o)** çdo lloj semundje apo keqfunksionim patologjik qe ka egzistuar perpara ketij sigurimi. **p)** kryerjes nga ana e te Siguruarit ne menyre te vetedijshme te veprimeve qe do te rrezikonin seriozisht ate, perjashto rastet kur ato kryhen per te shpetuar njerez ose mallra ne rrezik; **q)** çdo lloj sulmi apo sabotimi qe do te sillte rrezik nuklear ose perdorimin e armeve nukleare, kimike dhe biologjike ose clirimin e lendeve nukleare, kimike dhe biologjike; **r)** situates se semundjes ose te plagosjes te te siguruarit pas nje tentative vetevrasjeje; **s)** Shpenzimet me shtrim ne Spital ose ambulatore, medikamnetet, suplementet, lidhur me semundje qe rrjedhin nga Epidemi ose Pandemi te ndryshme; **t)** Semundjet infektive, Hepatitet a,b,c,d, Malarja, Kolera; **u)** aksidente qe shkaktojne direkt ose indirekt demtime trupore qe egzistonin perpara leshimit te polices, paaftesite e te siguruarit si dhe komplikacionet qe rrjedhin prej ketyre gjendjeve; **v)** situatat e tjera jashte garancise pervec atyre te parashikuara ne kushtet e pergjithshme te polices.

Perjashtimet perfishjne edhe rastet me poshte:a) Gjendje paraekzistuese; **b)** Pasojat apo aksidentet qe rrjedhin si pasoje e nje veprimi te qellimshem te te siguruarit si veteplagosja; **c)** Semundje apo aksidente gjate kohes qe i siguruari eshte me sherbim ushtarak; **d)** Plagosja apo lendime qe rrjedhin nga pjesemarrja aktive ne gara motorrike ne toke apo uje; **e)** Lendimet ose pasojat qe rrjedhin nga pjesemarrja ne sporte profesionale apo te rrezikshme; **f)** Aksidentet e transportit ajror, pervec rasteve kur udhetohet me nje mjet te certifikuar; **g)** Pasojat e trazirave apo kryengritjeve ku i siguruari duke marre pjese ne to thyen ligjin; **h)** Kurat e rinise apo bukurise, nderhyrjet per efekt estetike ose trajtimin me medikamente ose suplemente per kete qellim; **i)** Pasojat e ngjarjeve ne nje periudhe lufte, pervec nese ndodhin brenda 30 diteve; **j)** Demtimet e

shendetit si pasoje e rrezatimit jonik, elektromagnetik dhe rreziqeve te energjise berthamore; **k)** Vitaminat, suplementet, ekstraktet bimore, kremera, shampoo, parfume, preparate e higjenes; **l)** Kontracepsioni meshkuj apo femra, sterilizimi, hetimi, dhe kujdesi per fertilizim apo operacione per ndryshimin e seksit; **m)** Semundjet veneriane HIV/AIDS, hetimi apo pasojat; **n)** Te gjitha trajtimet per identifikimin, ruajtjen dhe permiresimin e shendetit te fetusit; **o)** Perkujdesi ndaj alkolizmit, vartesive nga droga; **p)** Lentet, skeletet dhe xhama optike apo kirurgjine radikale keratomike ne rast miopie, astigmatizem, hipermetropi, presbiopi; **q)** Kontrollet e zakonshme dentare dhe protezat; **r)** Shpenzimet per gjetjen dhe marrjen ne dorezim te organeve per transplant; **s)** Shpenzime per problemet e zhvillimit mendor; **t)** Trajtimi i obezitetit; **u)** Dializa; **v)** Cdo lloj trajtimi qe lidhet me shtatzanine; **w)** Medikamente ne shtrim dhe ambulatore; **x)** Shpenzimet shendetesore, spitalore ose ambulatore, ku shkak i demeve jane bere, automjete, mjete ose objekte te cilat posedojne nje Police Sigurimi pergjegjesie, te leshuar nga nje kompani sigurimi, vendase apo e huaj.

4. "PERSONA QE NUK SIGUROHEN"

a) personat qe vuajne nga alkolizmi,narkotizmi ose semundje mendore si skizofrenia, format maniako-depresive e gjendjet paranoike apo sindroma organike celebrale,gjendje ankthi; **b)** personat qe kerkojne kujdes te perhershem mjeksor, ku te tille konsiderohen personat qe mbeshtesin jetesen dhe nevojat e perditshme tek ndihma e te tjereve; Polica e Sigurimit zhvleresohet ne momentin qe vertetohen rrethanat e treguara ne pikat "a" dhe "b" te mesiperme; **c)** nuk sigurohen personat qe kane mbushur moshen 65 vjeç dhe qe kane historik semundjesh. Te siguruarit qe arrijne kete moshe kur polica e sigurimit eshte ne fuqi do te mbulohen deri ne mbarim te afatit te treguar ne policen e sigurimit; **d)** Personat qe kane semundje fizike te lindura.

5. "SHUMA E SIGURIMIT"

Shuma e sigurimit percaktohet ne policen e sigurimit sipas zerave ne rastet me apo pa shtrim ne spital si pasoje e semundjeve akute qe shfaqen ne menyre te papritur dhe qe nuk kane historic, ose aksidenteve, per te gjithe periudhen nje vjecare te sigurimit, pavaresisht nga numri i aksidenteve/ semundjeve.

6. "PRIMI I SIGURIMIT"

Primi i sigurimit aplikohet per afat nje vjecar. Primi i Sigurimit paguhet teresisht me nenshkrimin e polices se sigurimit. Vonesa ne pagesen e primit prej me shume se 7 ditesh nga data e prerjes se polices se sigurimit, i jep kompanise te drejten te nderprese kontraten e sigurimit;

7. "POLICA E SIGURIMIT"

- **Gjak Komplet**
- **Urine Komplet**
- **Glicemi Esell**
- **Kolesterol**
- **Trigliceridet**
- **Bilirubine totale**
- **SGOT**
- **SGPT**
- **EKG**
- **Eko Abdominale**
- **Mamografi/PAP Test/Grafi Toraksi/PSA**
- **Konsulte Patologu**

8. "HYRJA NE FUQI E POLICES"

Polica e sigurimit nga semundjet dhe aksidentet do te kete nje periudhe pritje prej 30 ditesh, dhe nuk do te hyj ne fuqi asnjehere para ketij afati dhe pasi te jene

respektuar te gjitha procedurat e marrjes ne sigurim nga specialist i ALBSIG.

9. "NJOFTIMET DHE DEKLARATAT E PASAKTA"

Njoftimet dhe deklaratat e pasakta ose te paplota te kryera me dashje perbejne shkak per zgjidhjen e polices se sigurimit. Siguruesi pranon te marre persiper kete sigurim, duke u bazuar tek kerkesa e te Siguruarit. I Siguruari eshte i detyruar te thote te verteten ne kerkese dhe ti pergjigjet saktë pyetjeve te bera ne dokumentet plotesuese ne se do kete, duke deklaruar aspektet qe dihen prej tij, te cilat perbejne thelbin e rrezikut dhe qe ndikojne ne vleresimin e rrezikut. Ne rastet kur behet deklarimi i manget, ose ne kundershtim me te verteten nga i Siguruari, Siguruesi mund te mos zbatoje ose te zbatoje ne kushte me te veshtira kontraten.

Nese i siguruari ka vepruar ne menyre te qellimshme, Siguruesi mund te mos e zbatoje kontraten, qe nga data qe informohet per situaten dhe nese demi eshte shkaktuar, te siguruarit nuk i paguhet demshperblimi. Ne rast se demi, pa veprimin e qellimshem te te Siguruarit, ndodh: **(i)** perpara se Siguruesi te vihet ne dijeni per situaten ose **(ii)** brenda peridhes qe Siguruesi mund te bej njoftimin e anulimit ose **(iii)** brenda periudhes kohore qe nevojitet per hyrjen ne fuqi te ketij njoftimi; atehere Siguruesi ben zbritje nga demshperblimi te diferences midis primeve te realizuara dhe atyre qe duhet te realizoheshin. Njoftimet ose deklarimet e pasakta ose te paplota te kryera ne mirebesim, perbejne shkak per zgjidhjen e polices se sigurimit, por i Siguruari ka te drejte mbi pjesen e primit per periudhen e mbetur te sigurimit. Gjithashtu i Siguruari demshperblehet deri ne shumen e sigurimit te dale nga raporti mes primit te sigurimit te rene dakort dhe atij qe duhej te ishte paguar. Kur polica e sigurimit eshte lidhur per me shume se një person, ajo mbetet e vlefshme per ata persona, te cileve nuk i referohen deklarimet e pasakta ose te paplota. Te gjitha njoftimet dhe deklarimet e te Siguruarit ose Kontraktuesit para dhe mbas nenshkrimit te polices behen me shkrim.

10. "FILLIMI DHE MBARIMI I SIGURIMIT"

Polica e sigurimit hyn ne fuqi ne oren 24.00 te dates se percaktuar si date fillimi ne kontrate, me kusht qe te jete paguar primi i sigurimit, dhe do te perfundoj ne oren 24.00 te dites se mbarimit te kontrates te percaktuar po ne police, te nenshkruar nga te dy palet. Periudha e sigurimit eshte 1-vjecare, pervec rasteve kur ne kontraten e sigurimeve do te percaktohet ndryshe. Polica e sigurimit perfundon ne rastet e meposhtme: **a)** kur mbaron afati i treguar ne policen e sigurimit; **b)** ne menyre te njeanshme kur njera nga palet nuk permbush detyrimet kontraktore. Kur pergjegjesia bie mbi Siguruesin, i Siguruari ose Kontraktuesi perfiton pjesen e primit te paguar per periudhen e mbetur te sigurimit; **c)** kur njera nga palet heq dore nga polica e sigurimit;Ne raste te tilla, palet jane te detyruara te njoftojne 30 dite perpara; **d)** pas nje ngjarje e cila konsumon tere shumen e mbetur te sigurimit.

11. "SIGURIMI I PJESTAREVE TE FAMILJES"

Me kusht qe te jete rene dakort nga palet kontraktuese dhe per mbulimet e shenuara ne tabelen e perfitimeve, me persona te siguruar do te kuptohen anetart e familjes te perbere prej jo me pak se 3 (tre) persona. Cdo pjesetar i familjes perfiton ne menyre individuale mbulimet qe ofron karta e shendetit. Primi i Sigurimit paguhet teresisht per gjithe familjen me nenshkrimin e polices se sigurimit. Vonesa ne pagesen e primit prej me shume se 7 ditesh nga data e prerjes se polices se sigurimit i jep kompanise te

drejten te prish kontraten e sigurimit.

12. "NDRYSHIMI I VEPRIMTARISE PROFESIONALE APO I PERSONIT TE SIGURUAR"

Ne rast se gjate periudhes se mbulimit ne sigurim, ndryshon veprimtaria profesionale e treguar ne policen e sigurimit, i Siguruari ose Kontraktuesi eshte i detyruar tenjoftoje me shkrim Siguruesin. Kur veprimtaria e re profesionale e shton shkallen e rrezikut, primi do te rritet per periudhen e mbetur te sigurimit. Kontraktuesi (ne rastet e aplikimit te sigurimit ne grup) ka te drejte qe te zevendesoje me nje tjeter personin qe ka caktuar per te marre shumen e sigurimit, apo te shtoje persona te tjere me te njejtat kushte te pergjithshme, duke njoftuar me shkrim Siguruesin brenda nje periudhe 15 ditore dhe paraqitur deshmine e sigurimit per te bere ne te shenimet e nevojshme.

13. "NJOFTIMI I RASTIT TE SIGURIMIT DHE DETYRIMET E TE SIGURUARIT"

I Siguruari ose Perfituesi duhet te njoftoje me shkrim Siguruesin per vertetimin e ngjarjes se sigurimit brenda 5 (pesë) diteve nga dita e gjendjes se renduar shendetesor apo aksidentit, ose nga momenti ne te cilin ka patur mundesi ta beje kete njoftim. Njoftimi me shkrim i Rastit te Aksidentit duhet te tregoje vendin, diten, oren, semundjen e tij apo shkakun e aksidentit, si dhe t'i bashkengjitet nje çertifikate mjeksore nga mjeku, i cili ndjek kurimin, ku te percaktohen shkaqet e semundjes dhe pasojat e mundshme te saj. Eshte kusht qe menjehere pas aksidentit ose semundjes te filloje kurimi dhe te merren masat e nevojshme per sherimin e te semurit. Siguruesi ruan gjithnje te drejten te vizitoje dhe te kontrolloje gjendjen shendetesore te te semurit ose te aksidentuarit dhe dhenia e lejes per viziten dhe kontrollin eshte e detyrueshme. Eshte e detyrueshme te zbatohen keshillat e mjekut,qe ndjek kurimin sa me siper, te cilat kane ndikim te drejteperdrejte ne sherimin e te plagosurit ose te aksidentuarit: **a)** Ne raste se i siguruari ne menyre te qellimshme nuk zbaton sa me siper, humbet te drejten qe i jepet nga polica; **b)** Ne rast kur si rrjedhoje e mangesive dhe mosveprimeve te te siguruarit efektet e aksidentit dhe te semundjes shtohen atehere Siguruesi nuk mban pergjegjesi per pjesen e shtuar;

I Siguruari duhet te ndjeke keshillat e mjekut dhe duhet te beje çdo perpjekje per te minimizuar pasojat e aksidentit. I Siguruari dhe, ne rast vdekje te te Siguruarit, Perfituesi, eshte i detyruar t'i lejoje Siguruesit te kryejne verifikimet dhe eksperimentimet e nevojshme lidhur me aksidentin. Siguruesi paguan demshperblimin vetem per pasojat e drejtperdrejta dhe ekskluzive te shkaktuara nga aksidenti. Ne rast se ne momentin e ndodhjes se aksidentit, i Siguruari nuk eshte fizikisht i plote dhe i shendetshem, jane te demshperblyeshme vetem pasojat qe do te mund te vertetoheshin patjeter, atehere kur aksidenti t'i kishte ndodhur nje personi fizikisht te plote dhe te shendetshem.

14. "SHPENZIMET SPITALORE DHE FARMACEUTIKE"

Shpenzimet spitalore dhe farmaceutike i paguhen te Siguruarit ose pjesterit te familjes te siguruar, ne rastet kur per shkak te nje semundjeje apo aksidenti ai ndodhet ne trajtim mjeksor ne institucione mjekimi ose jashte tyre. Shpenzimet spitalore dhe farmaceutike perfshijne: shpenzimet mjeksore spitalore dhe ambulatore, shpenzimet e trajtimeve kirurgjikale, shpenzimet farmaceutike, analizat dhe radiografite, shpenzimet per trajtimet fizioterapike dhe riaftesimit, si dhe shpenzimet per transportimin ne kushte speciale, te gjitha keto kur jane te lidhura me

nje semundje apo aksident te siguruar dhe te rekomanduara nga mjeku, ne perputhje me shumat e permendura ne tabelen e perfitimeve.

15. "KERKESA PER DEMSHPERBLIM"

I siguruari ose perfituesi, per marrjen e demshperblimit, i paraqet Siguruesit kerkesen me shkrim, e cila duhet te tregoje edhe emrin e te Siguruarit, numrin dhe daten e polices se sigurimit. I siguruari eshte i detyruar qe se bashku me formularet e njoftimit dhe te kurimit, te dorezoje edhe dokumentet origjinale plotesuar nga mjeku, ose spitali ku eshte kuruar, ne te cilat behet fjale per shpenzimet e spitalit, ilacet, kurimi, dhe vizitat e bera si rrjedhoje e aksidentit ose semundjes. Barra e shpenzimeve per marrjen dhe dergimin e ketyre dokumenteve tek Siguruesi eshte ne ngarkim te te Siguruarit.

16. "VLERESIMI I GJENDJES SHENDETSORE"

Vleresimi i gjendjes shendetsore kryhet mbi bazen e dokumenteve te paraqitura nga i Siguruari, nga eksperti apo grupi i eksperteve te caktuar nga Siguruesi. I Siguruari eshte i deryruar te paraqese menjehere, dhe ne çdo rast, jo me vone se 30 dite, çertifikatat mjeksore apo çdo lloj dokumentacioni tjeter qe lidhet me semundjen/aksidentin ose qe kerkohet nga Siguruesi. Eksperti apo grupi i eksperteve eshte i detyruar te hartoje akt-ekspertimin brenda 10 diteve nga marrja e dokumentacionit, perveç kur shkalla e demtimeve nuk mund te percaktohet brenda nje afati te tille.

17. "DEMSHPERBLIMI"

Siguruesi eshte i detyruar te paguaje demshperblimin ose ta refuzoje ate kur nuk permbushen kushtet e parashikuara ne kete kontrate brenda 30 diteve nga marrja e dokumentacionit te rregullt te demshperblimit. Pagesa e demshperblimit behet ne monedhen e treguar ne policen e sigurimit.

18. "SIGURACIONI I PERBASHKET"

I siguruari eshte i detyruar te lajmeroje Siguruesin nese eshte i siguruar per te njejtin qellim ne Sigurues te tjere. Ne rast se shpenzimet e kurimit mundesohen prej me shume se nje shoqerie sigurimesh, shpenzimet ne ale do te perpjestohen midis shoqerive ne raport me garancite e tyre.

19. "RUAJTJE E FSHEHTESISE"

Siguruesi detyrohet te ruaje konfidencialitetin e te dhënave, fakteve dhe rrethanave qe kane te bëjne me te siguruarit, te dhena me te cilat njihet gjate ushtrimit te veprimtarise se vet. Ai do te jete pergjegjes per demet qe do te shkaktohen si rrjedhoje e mosruajtjes se fshehtesise ne lidhje me sekretet e te Siguruarit.

20. "LAJMERIMET DHE NJOFTIMET"

Lajmerimet dhe njoftimet behen me shkrim dhe i dergohen shoqerise se sigurimeve, ne qendren e saj ose agjensise ndermjetese te kontrates se sigurimeve. Edhe lajmerimet dhe njoftimet e shoqerise se sigurimeve kundrejt te Siguruarit ose Kontraktuesit behen ne adresen e shkruajtur ne police. Ne rast se adresat kane ndryshuar, ato duhet te njoftohen menjehere me shkrim.

21. "DISPOZITA TE TJERA"

Nëse në momentin e ndodhjes së një rasti sigurimi, sipas kësaj kontrate ekzistojnë sigurime të tjera, të cilat mbulojnë të njëjtin dëm, masa e dëmshperblimit që përfiton i Siguruari nga të gjitha kontratat e sigurimit nuk mund të jetë më e lartë sesa masa e dëmit. Pjesa e dëmit që paguajnë Siguruesit

është propocionale me shumat e siguruara. Siguruesit i lind detyrimi vetem per dokumentat qe jane nenshkruar nga persona te autorizuar nga perfaqesuesi ligjor i saj. Asnje tjeter nuk ka te drejte te nenshkruaj ose te modifikoj policat e sigurimit ne emer te siguruesit, ose te paranoje deklarata apo dokumenta ligjor.
Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis Siguruesit dhe te Siguruarit, ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, zgjidhen me rruge gjyqsore. Gjykata kompetente per shqyrtimin e ceshtjeve gjyqesore qe celen kunder shoqerise se sigurimeve si rrjedhoje e mosmar- reveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane. Perveç sa eshte parashikuar shprehimisht ne dispozitat e ketyre kushteve te sigurimit, do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil te R.SH.

GENERAL CONDITIONS OF HEALTH INSURANCE

1. "OBJECT OF INSURANCE"

Within the scope of the present general conditions and the categories and limits defined in the List of Benefits, ALBSIG SHA, Str. George W. Bush, Nr. 10, Tirana shall bear the cost of medical treat ment that necessitates from illness, bodily injuries from accidents, maternity and preventive care.

2. "DEFINITIONS"

Accident-Any sudden, unexpected and unforeseen event occurring without the insured's intention, identifiable as to time and place of occurrence, which has a direct external and violent impact on the insured's body; **Ceiling of coverage** is the maximum amount that the Insurer will pay for each benefit defined specifically in the list of benefits during the period of coverage for any treatment covered under the terms and conditions of this policy which as a separate or total expense can not exceed the annual limit defined in the policy; **Coverage Period** is the period of time during which the insurance contract is valid, which is specified in the policy form and which can be no longer than a year; **Deductible** the initial portion of a covered expense that must be paid by the insured before ALBSIG pays its part of the expense; **Emergency** a condition that can be affirmed in case of an accident, or any sudden beginning or worsening of a severe illness resulting in a medical condition that presents an immediate threat to the health and therefore requires urgent medical measures. Only medical treatment by a physician, general practitioner or specialist or hospitalizations that commences within 24 hours of the emergency — causing event

will be covered as such; **Illness**-Any unintended impairment of the state of health diagnosed by a medical practitioner that is not the consequence of an accident. Complications that develop during pregnancy or childbirth are considered illnesses; **Home Nursing** denotes nursing services, received immediately after hospitalization, which are prescribed by a physician and delivered in the home of the Insured by a registered nurse; **Hospital** is a juridical establishment licensed as a medical or surgical hospital by the appropriate authorities in the country in which it is located, whose main purpose is the treatment, on the premises, of the sick and injured, where the patient is under the constant supervision of a physician, and where a medical file on each case is kept up to date. The following types of establishment are not considered hospitals: spas, hydro clinics, sanitaria, rehabilitation institutions for disabled persons, physiologists, sociologists and similar professions nursing homes or homes for the elderly; **Hospitalization/ In-patient treatment** - All stays as a patient in a medical facility/hospital on the advice of and under the regular care and attendance of a medical practitioner and exceeding uninterrupted duration of 24 hours; **Medical Practitioner/Physician**-Any medical practitioner holding a state-authorized diploma to exercise the medical profession or holding an equivalent international diploma; **Medical Provider**-A professionally licensed individual of juridical entity or entity providing medical related services to patients. Physicians, hospitals, clinics, pharmacies, chiropractors, nurses, nurse-midwives, physical therapists, laboratories are providers; **Outpatient surgery**-surgery in a medical facility/hospital where it is not medically necessary for the patient to stay for a period greater than 24 hours; **Policyholder**-The policyholder is the individual or legal entity that concludes the insurance contract with ALBSIG sha; **Pre-existing conditions**-Any disease, illness and/or bodily injury that either: **a)** has been diagnosed by a physician or has required medical treatment, including prescrip- tion of drugs, prior to the effective date of the policy; **b)** exhibited symptoms, prior to the effective date of the policy, which could cause an ordinary prudent person to seek medical advice or treatment; **ALBSIG Medical Network** shall include all medical providers which have an agreement with ALBSIG, and which have been chosen by ALBSIG to provide the Insureds with medical services. Treatment All scientifically recognized care given that aims to reestablish or conserve health. The treatment must be recognized as a medical one by the state it is given in and have to conform to medical prescriptions; **Waiting Period** a period of time from the effective inception date where the insurance provides no cover for the medical expenses received during that period unless specifically defined otherwise in these General Conditions.

3. "GENERAL PROVISIONS"

The health and accidents insurance is based on: **a)** the present General Insurance Conditions (hereinafter referred to as the 'General Conditions'), any existing complementary conditions, as well as the provisions contained in the policy and any existing supplements thereto; **b)** the Albanian legislation for the issues not provided for in paragraph a); **c)** the written statements made by the applicant in the application form and in any other relevant documents.

4. "BENEFITS"

The benefits granted are defined in the

